

VENDIM
Nr.322, datë 21.5.2004

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE, QË RIMBURSOHEN NGA INSTITUTI I
SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE MASËN E MBULIMIT TË ÇMIMIT
TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 15 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuara, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Masa e mbulimit të çmimeve të listës së barnave, që rimbursohen sipas klasifikimit ATC, të jetë në masën nga 50 për qind deri në 100 për qind.

3. Masa e mbulimit të çmimeve të listës së barnave, që rimbursohen sipas grupeve, të jetë si më poshtë vijon:

Grupi I- Masa e mbulimit të jetë 100 për qind.

Në këtë grup përfshihen barnat, që kanë nivelin më të lartë të rimbursimit dhe bëjnë pjesë në grupet terapeutike: J04, L01, L02, L03, L04, M05, J04, V03, përkatësisht:

- Antimykobakterialët;
- Barna antineoplazmike;
- Barna të terapisë endokrine;
- Imunostimuluesit;
- Imunosupresivët;
- Barna për trajtimin e çrregullimeve të sistemit muskulo-skeletik;
- Të gjitha produktet e tjera terapeutike.

Grupi II- Masa e mbulimit të jetë nga 85 për qind deri në 95 për qind.

Në këtë grup përfshihen barnat, sipas klasifikimit ATC, që bëjnë pjesë në grupet terapeutike: A09, A10, B01, B03, H01, H05, M04, N03, N04, N07, përkatësisht:

- Digjestivët, përfshi enizmat;
- Antidiabetikët;
- Antikoagulantët;
- Hormonet e hipofizës dhe hipotalemikët;
- Kalcium homeostatikët;
- Preparatet antigutoze;
- Antiparkinsonikët;
- Barna të tjera për sistemin nervor.

Grupi III – masa e mbulimit të jetë nga 75 për qind deri në 85 për qind.

Në këtë grup përfshihen barnat, që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: C01, C02, C04, C08, C09, H03, J05, N05, R03, përkatësisht:

- Barnat në terapitë kardiale;
- Antihipertensivët;
- Vazodilatorët periferikë;
- Kalciblokuesit;
- Barnat vepruese në sistemin renin-angiotensin;
- Barnat në terapinë e tiroides;
- Barna antivirale, sistemike;
- Psikoleptikët;
- Antiasmatikët.

Grupi i IV- Masa e mbulimit të jetë nga 65 për qind deri në 75 për qind.

Në këtë grup përfshihen barnat, që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: A02, A07, B05,

C03, C07, C10, G01, G02, G04, H02, N02, N06, përkatësisht:

- Antiacidet, barnat për mjekimin e ulcerës peptike dhe flatulencës;
- Antidiarreikët, antiinflamatorët dhe antiseptikët intestinalë;
- Zëvendësuesit e plazmës dhe perfuzionet;
- Betablokuesit;
- Barnat për reduktimin e lipideve në gjak;
- Antiinfektivët dhe antiseptikët gjinekologjikë;
- Barna të tjera gjinekologjike;
- Urologjikët;
- Kortikosteroidet sistemike;
- Analgjezikët;
- Psikoanaleptikët.

Grupi V- Masa e mbulimit të jetë nga 55 për qind deri në 65 për qind.

Në këtë grup përfshihen barnat, që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: A03, A05, A11, B02, C05, G03, J01, J02, M01, P02, R05, S01, përkatësisht:

- Barna antispastike, antikolinergjike dhe propulsive;
- Kolagogët dhe hepatoprotektorët;
- Vitaminat;
- Antihemoragjikët;
- Vazoprotektorët;
- Hormonet seksuale dhe modulatorët e sistemit gjeneral;
- Antibakterialet sistemike;
- Antimykotikët sistemike;
- Antiinflamatorët dhe antireumatikët;
- Antihelmentikët;
- Barnat kundër kollës dhe rrefës;
- Barnat oftalmike.

Grupi VI – Masa e mbulimit të jetë 50 për qind.

Në këtë grup përfshihen barnat, që kanë nivelin më të ulët të rimbursimit dhe bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: D01, D06, D07, R01, R06, V07, përkatësisht:

- Antimykotikët dermatologjikë;
- Antibiotikë dhe kimioterapeutikë dermatologjikë;
- Preparatet dermatologjike të kortikosteroideve;
- Preparatet nazale;
- Antihistaminikët sistematikë;
- Të gjitha produktet e tjera joterapeutike.

4. Masa e mbulimit të çmimeve të barnave alternative, e përcaktuar në pasqyrën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të jetë 50 për qind.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

6. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të përcaktojë kufizimet në përdorimin e barnave të listës së barnave të rimbursueshme.

7. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimi nr.321, datë 15.5.2003 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano